

# GËZUAR KRISHTLINDJET!



Edhe Josifi, burri i saj, duke qenë i drejtë, e duke mos dashur t'i nxjerrë asaj zë të lig, deshi ta lëshojë fshehurazi. Po ndërsa ai ishte duke menduar këto, ja një engjëll i Zotit tek iu duk në ëndërr, duke thënë: Josif, bir i Davidit, mos u frikëso të marrësh me vete gruan tënde Mariamin; sepse mbarsja që u bë tek ajo është nga Shpirti i Shenjtë. Edhe do të lindë djalë dhe do t'ia quash emrin Jisu; sepse ai do të shpëtojë popullin e tij nga fajet e atyre.

Edhe gjithë kjo u bë, që të përmbushet e thëna prej Zotit me anë të profetit, që thotë: “Ja virgjëresha tek do të mbarset, dhe do të lindë djalë, dhe do t'ia quajnë emrin Emanuel”, që e përkthyer domethënë, Perëndia bashkë me ne.

Edhe Josifi, si u zgjua nga gjumi, bëri siç e urdhëroi engjëlli i Zotit, dhe mori pranë vetes gruan e tij. Edhe nuk e njohu atë, derisa bëri të birin e saj, të parëlindurin; dhe ia vuri emrin Jisu.

*Matth 1:19-25*



# RINGJALLJA

Nr. 12 (167) Viti XV i botimit

DHJETOR 2006

Çmimi 20 lekë

## “Vlera, besime, identitet”

- Veprimtari e Konferencës Evropiane të Kishave -

Me rastin e 50-vjetorit të Traktatit të Romës, udhëheqësit fetarë dhe pjesëmarrës nga 50 kisha dhe 28 vende nga e gjithë Evropa u takuan në datat 12 dhe 13 dhjetor 2006 në Bruksel me ftesë të Komisionit për Kishën dhe Shoqërinë të Konferencës së Kishave Evropiane. Takimi u zhvillua pikërisht në kohën kur debati për të Ardhmen e Evropës dhe të Traktatit Konstitucional Evropian është në një udhëkryq.

Veprimtaria u hap mbasditen e datës 12 dhjetor, me temën “Vlerat evropiane - dialogu i kishave me institucionet politike evropiane”. Një sesion i dytë iu kushtua temës: “Mbi ç’vlera u ndërtua Evropa. Kontributi i kishave.”

Në datën 13 Konferenca vazhdoi me temën: “E ardhmja e projektit evropian”. Në të folës ishte edhe Kryepiskopi Anastas, që është edhe Zëvendës-presidenti i këtij organizmi, i cili mbledh në gjirin e vet 125 Kisha të krishtera të Evropës, si dhe 40 organizata të asociuara. KEK u themelua në vitin 1959.

Në fund Konferenca miratoi edhe një deklaratë të përbashkët, të cilën po e botojmë pjesërisht në këtë numër.



### Kryepiskopi Anastas shpallet “Qytetar nderi” i Korçës

Në mbledhjen e tij të datës 18 dhjetor, Këshilli Bashkiak i qytetit të Korçës mori në shqyrtim kërkesën për të shpallur “Qytetar nderi” Kryepiskopin e Tiranës, Durrësit dhe të gjithë Shqipërisë. Kërkesa ishte bërë nga 250 intelektualë të njohur të qytetit dhe bazohej në veprën e jashtëzakonshme të Fortlumluturisë së Tij për ringjalljen e be-

simit orthodhoks në përgjithësi dhe në veçanti në kontributin për qytetin dhe gjithë Dioqezën e Korçës, për ringritjen e godinave dhe strukturave kishtarë etj.

Në fund, me shumicën dërrmuese të votave, nga të dy krahët politikë, u vendos që Kryepiskopi Anastas të shpallet “Qytetar nderi” i Korçës.

## Letër e hapur nga udhëheqësit fetarë për liderët politikë të Evropës

# Për një Evropë të bazuar mbi vlera dhe shpresa të përbashkëta

...Ne u takuam pikërisht në kohën kur debati për të Ardhmen e Evropës dhe të Traktatit Konstitucional Evropian është në një udhëkryq.

Duke u përgatitur me kishat tona, për Asamblenë e Tretë Ekumenike në Sibiu të Rumanisë, në shtator 2007, gra dhe burra nga pothuajse të gjitha kishat e Evropës do të reflektojnë se në çfarë konsiston kuptimi i një Kise në Evropën e sotme.

Ne besojmë, se besimi me anë të Jisu Krishtit, e vë shpresën tek Perëndia, i Cili është një faktor aktiv në realitetin e përditshëm. Trashëgimia shpirtërore e Krishterimit përbën një burim të fortë të inspirimit dhe të pasurimit për Evropën. Feja është një faktor i gjallë dhe konstruktiv për jetën publike.

Ne duam të ndajmë me ju, liderët politikë të Evropës, shqetësimet dhe shpresat tona për të ardhmen e Evropës dhe rolin tonë brenda saj. Në mënyrë të veçantë, bindja jonë është se procesi i integritit evropian, duhet të vazhdojë i bazuar në vlerat dhe vizionin e përbashkët.

### 1. Evropa - Një kontinent i bashkuar në diversitet

Me zhvillimin e integritit evropian, vizioni dhe angazhimi për vlerat e përbashkëta u reflektuan në institucionet e krijuara nga ky proces. Këshilli i Evropës dhe OSBE kultivuan një Evropë të ndërtuar mbi respektin e të drejtave njerëzore, të lirisë fetare, të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës. Pajtimi dhe solidariteti ishin gurët e themelit të asaj që është sot Bashkimi Evropian.

Vlera thelbësore duhet të mbahen gjallë dhe të praktikohen si udhërrëfyese për krijimin e politikës. Sot pjesa më e madhe e popujve të Evropës gëzojnë lirinë dhe të drejtat themelore njerëzore dhe kanë kohë që nuk po përballen më me luftën dhe konflikte të dhunshme. Megjithatë pasojat negative të ndarjes së Evropës në të shkuarën janë ende të dukshme dhe nëse kërkohet kapërcimi i tyre, atëherë kërkohet realizimi i plotë i këtyre vlerave origjinale. Institucionet evropiane dhe shtetet anëtare kanë një rol në sigurimin dhe mirecurinë e këtyre vlerave.

Ndërkohë që pjesë të Evropës kanë lëvizur drejt një uniteti më të madh, diversiteti ngelet karakteristika e identitetit të kontinentit. Diversiteti i kulturave, traditave dhe identiteteve fetare duhet të respektohet.

Evropa nuk është sinonim i Bashkimit Evropian. BE ka përgjegjësi për të punuar ngushtë me të gjitha vendet evropiane dhe të sigurojë që politikat e fqinjësisë të orientojnë në marrëdhënie të drejta, të ndershme dhe mbështetëse me fqinjët e tij. Ne i nxisim politikanët e Evropës të ripërtërijnë angazhimin e tyre për të kërkuar një vizion të përbashkët evropian, vlera dhe politika të përbashkëta.

### 2. Evropa - Një kontinent i vlerave të përbashkëta

#### 2.1 - Paqe dhe Pajtim

Integriti evropian luan ende një rol kryesor në sigurimin e paqes dhe të pajtimit midis shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Zgjerimi i BE-së që pasoi fundin e Luftës së Ftohtë, çoi në shpresën se lufta dhe konfliktet e dhunshme midis shteteve evropiane as nuk mund të mendohen. BE luan një rol në rritje në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Ne duam që BE të balancojë rritjen e tanishme të kapacitetit të tij ushtarak duke fuqizuar iniciativën joushtarake, siç janë vendosja e Institutit Evropian të Paqes për të investiguar, mbështetur dhe forcuar përpjekjen e përbashkët të vendeve evropiane në forma jo të dhunshme të parandalimit të konflikteve, ndërmjetësimit dhe të menaxhimit të konflikteve.

#### 2.2 - Integriti evropian

Integriti evropian i fton njerëzit të zhvillojnë marrëdhënie dhe nuk kufizohet vetëm në dimensionet politike dhe ekonomike. Marrëdhëniet e thella dhe zgjerimi gjeografik janë të pandashme dhe duhet të ecin së bashku.

Perspektiva e BE-së ka ngjallur shpresa dhe ka iniciuar procese reformuese në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi. Angazhimet ndaj parimeve të pranuar, ndaj Kartës themelore të të Drejtave të Njeriut dhe mbështetja për popullin janë thelbësore për asociimin dhe pranimin e proceseve që vijnë si rrjedhojë e tij.

Si njerëz prej traditave dhe kulturave të ndryshme në Evropë, që mblidhemi së bashku, ne duam që të kemi dialog ndërfaqet dhe ndërkulturor. Evropa është shtëpia për popuj të shumë kombeve, kulturave dhe feve. Ne i ftojme edhe fetë

e tjera që të marrin pjesë në shqetësimet e përbashkëta. Evropa është gjithashtu një parajsë për emigrantët, refugjatët, azilkërkuesit. Rëndësia e personave që duhet të mbrohen për t'i shpëtuar persekutimeve, konflikteve të dhunshme dhe padrejtësive të strukturave ekonomike duhet të theksohet. Ne duam të ofrojmë një kontribut për "Vitin e dialogut ndërkulturor" në vitin 2008. Iniciativa të tilla janë të vyera, megjithatë nuk mjaftojnë. Ne i nxisim liderët politikë të mbështesin masat për një dialog të qëndrueshëm, afatgjatë dhe angazhohemi të punojmë bashkë me ju.

#### 2.3 - Evropa dhe Globalizmi

Pasuria e Evropës bie në një kontrast të dukshëm me kushtet e popujve në shumë pjesë të rruzullit. BE dhe shtetet e tjera evropiane kanë përgjegjësi për të punuar për një ekonomi botërore të balancuar ku mbizotërojnë marrëdhënie të drejta tregtare, me politika të barabarta emigrimi dhe të marrë fund shfrytëzimi ekonomik. Veprimet evropiane të kohëve të fundit, i çojnë shumë njerëz të mendojnë se po punohet në drejtimin e kundërt me këtë synim.

Duhet të përmendim pabarazinë e ndarjes së pasurisë në Evropë: Kontrasti i pasurisë së Evropës me papunësinë e saj dhe diferenca e madhe midis të pasurve dhe të varfërve. Kishat dhe programet e tyre sociale duhet të shikojnë efektet e këtyre dukurive në nivelin bazë, ku shpeshherë këta organizma janë mbështetja e vetme për ata që janë privuar nga siguria e sistemeve të mirëqenies.

Pasuria e Evropës gjithashtu ka kuptimin se ajo ka resurse për të "djegur". Si përgjigje ndaj ndryshimeve të klimës, BE duhet të vazhdojë rolin e tij drejtues për garancinë se të gjitha shtetet pjesëmarrëse duhet të mbajnë angazhimet e tyre sipas protokollit të Kiotos. Gjithashtu është një nevojë urgjente zhvillimi i iniciativave ku energjia prodhohet nga burime ripërtëritëse.

#### 2.4 - Evropa për njerëzit

Njerëzit ndihen të përjashtuar nga procesi kompleks i vendimmarrjes i institucioneve evropiane të BE. Kishat i mirëpresin iniciativat për të kryer dialog me qytetarët e BE, siç është "Plani D", që kultivon demokracinë, dialogun dhe debatin. Megjithatë ne jemi të shqetësuar se kjo gjë nuk ka një impakt pavarësisht kohës së iniciimit të saj. Kishat përpiqen të shikojnë përpara për të mbështetur dhe marrë pjesë në iniciativën "Qytetarët e Evropës" dhe shpresojnë se do të bëhen përpjekje serioze për të filluar një dialog real me të gjithë sektorët e shoqërisë. Kjo duhet të japë efekte për të hapur një dialog transparent dhe të rregullt, të parashikuar në nenet 1-47 dhe 1-52 të Traktatit Konstitucional Evropian.

Kishat, duke u angazhuar në mënyrë aktive në procesin e Traktatit Konstitucional, i urojnë mirëseardhjen. Kisha u rikujton politikanëve se duhet të dëgjojnë zërat e njerëzve, në mënyrë të veçantë të atyre që e ndiejnë se u vihet më tepër theksi objektivave ushtarakë dhe se u kushtohen fonde të pamjaftueshme programeve që prekin fushën sociale. Ne angazhohemi se do të përpiqemi të kërkojmë në mënyrë aktive të lehtësojmë dialogun dhe të inkurajojmë pjesëmarrjen e njerëzve në nivel lokal anembanë Evropës, për të krijuar fytyrën e ardhshme të saj.

### 3. Evropa - Shpresë dhe Angazhim

Historia e Evropës është dalluar jo vetëm për luftërat dhe konfliktet e armatosura, në të cilat edhe vetë Kishat janë implikuar disa herë, por edhe për zhvillimet e reja në politikë, ekonomi, shkencë dhe kulturë. Rigjallërimi i besimit të krishterë duhet të ndihmojë shoqëritë e Evropës për të ruajtur identitetet e tyre dhe për të zhvilluar vlera, të cilat përbëjnë zemrën e kulturës evropiane.

Ne jemi të angazhuar të mbrojmë vlera bazë kundër shkeljeve të çdo lloji dhe për t'i rezistuar çdo përpjekjeje për të keqpërdorur fenë për qëllime politike. Për më tepër ne jemi të angazhuar, sa është e mundur të gjithë, për të komunikuar shqetësimet dhe vizionet tona tek institucionet evropiane. Në këtë mënyrë ne kërkojmë të ofrojmë kontributin tonë për të ardhmen e Evropës dhe për ta kthyer në një kontinent të shpresës. Ne e vëmë shpresën tonë në Perëndinë si thuhet në Letrën e Apostullit Pavlit drejtuar Romakëve, që përmban shpirtin e Kartës Ekumenike: "Edhe Perëndia i shpresës ju mbushtë me çdo lloj gëzimi e paqeje me anë të besimit, që të teproni në shpresë me anë të fuqisë së Shpirtit të Shenjtë" (Rom. 15:13).

**Intervistë  
e atë Artur Liolinit  
dhënë gazetës  
“Shqip”**

***I urojmë  
punë të mbarë  
dhe të bekuar!***

*Kancelari i Kishës Orthodhokse të Bostonit, e cila është një vatër jo vetëm fetare për shqiptarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shumë i njohuri atë Artur Liolini, tregohet menjëherë i gatshëm të flasë për situatën në Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, por edhe për probleme të tjera në lidhje me shqiptarët kudo që ndodhen. Duke folur në një intervistë ekskluzive për gazetën “Shqip”, atë Liolini, synon të japë një mesazh pajtimi mes orthodhoksëve, duke lëshuar për të parën herë një mesazh që nuk e kishte thënë më parë, duke i kërkuar Presidentit të Republikës, që t’i japë shtetësinë shqiptare Kryepiskopit Anastas.*

*Së fundmi, në Shqipëri ka shpërthyer një polemikë, në lidhje me emërimin e një prifti joshqiptar, por me kombësi dhe nënshtetësi greke, si drejtues i komunitetit orthodhoks të Jugut të Shqipërisë. A mund të më thoni ju lutem, opinionin tuaj në lidhje me këto zhvillime?*

Kam lexuar për emërimin e mitropolitit Dhimitër (Sinaiti) në fronin e Gjirokastrës. Imzot Dhimitri ka shërbyer si arkimandrit dhe dekan i kësaj kishe për afro 14 vjet me radhë, periudhë në të cilën nuk kemi dëgjuar ndonjë gjë veçse fjalë të mira për sjelljet e tij. Besoj se edhe Presidenti i Republikës mori pjesë në shërbesat e kësaj kishe vitin e kaluar për festat e Krishtlindjes dhe dha komente për shqipen e bukur që dëgjoji gjatë shërbesës. Kështu, me këto të dhëna jemi të gëzuar se një shërbëtor i Zotit me nam të mirë udhëheq ta-



ni peshkopatën e Gjirokastrës, e cila ishte vakant për shumë vite. Kemi shpresë se imzot Dhimitri, i cili ka shërbyer në gjuhën shqipe, si dhe greqisht, do plotësojë detyrat për të mirën e famullisë së tij.

*Atë Liolin, me emërimin e mitropolitit të Gjirokastrës me kombësi greke, Sinodi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dominohet nga klerikë grekë, duke prishur kështu ekuilibrin e autoqefalisë. Ju Hirësi, si i konsideroni këta ekuilibra të tjerë?*

Sipas lajmeve zyrtare nga Kryesia e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, anëtarët e Sinodit të Shenjtë janë 4 klerikë të lartë me kombësi shqiptare, 1 që është arvanitas dhe dy me prejardhje nga Greqia. Por për më shumë rëndësi, të gjithë kanë shërbyer në Shqipëri për vite me radhë me sjellje tepër korrekte dhe të përshtatshme siç u takon klerikëve të nder-

shëm. Jemi të gëzuar se në të njëjtin vendim u zgjodhën edhe dy peshkopë të tjerë: Imzot Nikolla (Hyka), i cili do të kryesojë Akademinë Teologjike në Durrës, dhe imzot Andon (Merdani). Të gjitha këto janë shenja pozitive dhe raste për t’u gëzuar. I urojmë punë të mbarë dhe të bekuar.

*Kreu i kishës së Shën Marisë në Elbasan, atë Nikolla Marku, ka kërkuar që në situatën aktuale në gjirin e Kishës Orthodhokse, duhet të ndërhyjë edhe komuniteti shqiptar i SHBA-së dhe në veçanti, ka kërkuar ndërhyrjen Tuaj si personalitet jo vetëm i orthodhoksëve shqiptarë. A e shikonit të arsyeshme ndërmjetësimin për të qetësuar, apo për të zgjidhur këtë polemikë ndërmjet orthodhoksëve në territorin e Republikës së Shqipërisë?*

Nuk e shoh si të përshtatshme ose të nevojshme, në fakt, për një klerik të Kishës Orthodhokse të

Amerikës të ndërhyjë në punët e brendshme të Kishës Autoqefale të Shqipërisë. Megjithatë, nuk jemi indiferentë. Gjatë udhëtimeve të mia në 2005-ën, si dhe udhëtimin e episkopit shqiptaro-amerikan, Niko i Bostonit, në pranverën e kaluar, e pamë që struktura e kishës atje është vendosur mirë dhe me kujdes, si dhe udhëheqësit vazhdojnë të bëjnë çdo gjë për të mirën e të gjithë besimtarëve atje, e vendimet e përshtatshme për shtetin shqiptar. Në përgjithësi, përgatitjet për një kuadër të klerit - si famullitarë të thjeshtë ose si klerikë të lartë - janë në një rrugë të mirë që i takon një kishe autoqefale.

*I nderuar atë Liolini, kreu i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Anastas Janullatosi, ka aplikuar sërish për të marrë shtetësinë shqiptare te Presidenti i Republikës. Ju si mendoni, a do të ishte kjo zgjidhja e duhur, apo vendi ynë është i përgatitur, që të ketë në krye të Kishës Orthodhokse Autoqefale një shqiptar të pastër, siç ka dashur gjithmonë Imzot Noli?*

Më duket se Imzot Anastasi e meriton një lloj nënshtetësie, për ta nderuar punën e tij të palodhur, të ndershme dhe të shumanshme për të mirën e një pjese të madhe të popullsisë shqiptare dhe për një institucion të rëndësishëm siç është Kisha Autoqefale, si dhe për sjelljet e tij shembullore pa dallim feje. Një gjest nderi i këtitill do të pritët mirë nga udhëheqësit fetarë në Evropë dhe do të forcojë imazhin e Shqipërisë, si një shtet që vërtet duhet pranuar në Bashkimin Evropian. Të gjithë e dimë se Imzot Fan Noli shpresonte për një kishë autoqefale në gjithë kuptimin e fjalës. Besoj se edhe Imzot Anastasi vepron për këtë qëllim, siç ka thënë më shumë se një herë publikisht. Por nuk duhet ta kufizojmë mendjen e Nolit ose ta shohim vetëm si një figurë të mbetur në hapësirën kohore kur ka pasur aktivitetin, pra në vitin 1911. Historia kalon, ndryshon dhe evoluon, dhe na jep sfida të ndryshme për ta kapërcyer. Ka shumë raste në jetën dhe veprat noline kur e shikonte realitetin me sy të qartë dhe cilësonte çdo rast me vë-



(Vijon në faqen 4)

(Vijon nga faqja 3)

mendje dhe largpamësi. Për mendimin tim, unë jam i sigurt se Noli do ishte mik me Imzot Anastasin, se të dy gëzojnë arsim të lartë e të thellë, vizion të gjerë intelektual dhe një frymë të hapur e të gjerë jo vetëm për orthodhoksinë, por edhe për rolin e besimit për njeriun në përgjithësi. Të dy shfaqin respekt për traditën dhe zakonet e ndryshme, kulan nëpër sfida, ambiente dhe punë të rëndësishme, delikate dhe të lodhshme. Dhe të dy trupëzojnë një frymë më përparimtare dhe një mendje të hapur për fenë e tyre.

\* \* \*

*Atë Arturi, duke qëndruar në marrëdhëniet shqiptaro-greke, kohët e fundit në Shqipëri ka pasur debate, në lidhje me varrezat e ushtarëve grekë që janë vrarë në territorin shqiptar, gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Në këtë debat u përfshinë edhe disa priftërinj orthodhoksë që nisën zhvarrimin e disa varreve për të gjetur eshtra shqiptarësh, por edhe diplomatë grekë. Cili do të ishte opinioni juaj?*

Më duket një çështje që ishte komplekse dhe patjetër u rritën emocionet. Siç e di unë prej së largu, prifti i Kosinës bëri vetëm lutje dhe detyrat e tij fetare që i përkasin një kleriku. Kur u nisën bisedimet zyrtare për këtë çështje, u formua një komision që duhej të merrej menjëherë me detajet e kësaj pune delikate. Edhe këtu e kanë në dorë të dy qeveritë ta zgjidhin problemin dhe të gjitha derivatet që dalin, në aspektet më specifike.

*Duke Ju kërkuar ndjesë për shqetësimin, a mund ta mbyllim intervistën me një mesazh tuajin për të gjithë shqiptarët?*

Si gjithmonë, urojmë gjithë shqiptarët të mbajnë lart vlerat, trashëgiminë dhe aspiratat e tyre, me krenari, por edhe me gjakftohtësi dhe objektivitet. Problemet e Shqipërisë janë lidhur jo vetëm me ato të rajonit ose të kontinentit të tyre, por edhe me gjithë botën. Marrim shembullin edhe këtu nga Fan Noli ynë, i cili kujdesej me mish e me shpirt gjithmonë për Shqipërinë, por edhe kishte tru të zhvilluar dhe mejtime shumë të gjera, kozmopolit dhe u interesua për probleme botërore: të pushimit të luftërave, të ekologjisë, të etikës dhe moralit dhe për një paqe midis të gjithë popujve të botës. Ai dinte fort mirë se të gjithë ne banojmë në një botë, ngrohemi nga një diell, kemi shpresa të përbashkëta, lutemi për një të ardhme paqësore dhe përparimtare dhe eventualisht do të hyjmë kështu tok, duke shpresuar për një jetë më të mirë se deri tani për të gjithë shqiptarët, kudo që ata jetojnë.



Boston, kisha e Shën Gjergjit

Berati në rrjedhat e historisë

## KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

Berati, qyteti elitar dhe i magjishëm me shumë histori, me një pafundësi vlerash arkitektonike, artistike, muzeale, kulturore etj., ftoi ditën e shtunë, dt. 9 dhjetor në një konferencë shkencore ndërkombëtare njerëz të njohur në fushën e kulturës dhe të artit, të cilët prezantuan kumtesat e tyre me tema të reja të zgjedhura enkas për këtë aktivitet. Ky aktivitet u organizua nga qendra "Art & Color" në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe bashkinë e Beratit, të cilët bënë një ftesë të veçantë për Bërthamën e Trashëgimisë Kulturore pranë Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, e cila u impenjua maksimalisht që të prezantohej sa më mirë në këtë aktivitet. Tema ishte posaçërisht e zgjedhur dhe e përpunuar duke evidentuar restaurimet dhe arkitekturën kishtarë të të gjitha periudhave, të cilat kanë lënë gjurmët e tyre në zonën që mbulon Episkopata e Beratit. Tema: "Restaurimi i kishave, monumente kulture në Episkopatën e Beratit" u mbajt nga dy përfaqësuesit e Bërthamës së Trashëgimisë Kulturore, prof. dr. Pirro Thomo dhe ark. rest. Gentian (Joan) Stratobërdha. Tema kishte si synim përshkrimin e gjendjes së monumenteve në fillim të viteve '90. Masat paraprake që u morën për rijetëzimin e tyre dhe më pas ndërhyrjet definitive për restaurimet e plota që risolli në vend imazhin e tyre të sfumuar gjatë kohës së kaluar. Një pjesë

ndërtuar. Kjo kumtesë u ndoq me interesim të madh nga pjesëmarrësit referues në këtë konferencë si dhe nga pjesëmarrës të cilët kishin ardhur për të ndjekur punimet. Shumë njerëz, duke na falënderuar për temën e mbajtur, na pyesnin të habitur duke iu referuar dhe imazheve të paraqitura të gjendjes ekzistuese të monumenteve dhe atyre të mbas-restaurimit, që si është e mundur realizimi i gjithë këtyre ndërhyrjeve restauruese profesionale është bërë vetëm me kujdesin dhe investimet e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Ishte një nga kumtesat që arriti përqendrimin më të madh të pjesëmarrësve. Në fund të aktivitetit patëm falënderime të veçanta nga kryetari i bashkisë së Beratit, z. Fadil Nasufi, drejtori ekzekutiv i qendrës "Art & Color" z. Andon Koço dhe nga prof. dr. Shaban Sinani. Një vlerësim tjetër që iu bë Bërthamës së Trashëgimisë Kulturore ishte edhe drejtimi i seancës së dytë nga prof. dr. Pirro Thomo.

Tema të tjera, të cilat plotësuan më së miri të gjithë spektrin e kësaj konference dhe që lanë mbresën e tyre, ne na duket me vend t'i përmendim më poshtë:

- Berati: "Partha" apo "Antipatrea"? - prof. dr. Neritan Ceka.

- "Gjurmë të shenjave të lashta muzikore bizantine në Kodikun e Purpurtë të Beratit" - prof. dr. Sokol Shupo.

- "Despotati i Beratit: nga Paleologët tek Muzakajt, shek. XIII-XIV" - prof. dr. Pëllumb Xhufi.

- "Disa të reja për sekretin e së Purpurtës së dorëshkrimit më të hershëm të Beratit".

- "Pagëzimi i mbretit bullgar Boris Mihail në Ballsh (Gllavenicë)" - Marian Ninov (Bullgari).

- "Rreth traditës së bashkëjetesës ndërjetare nëpër kohëra" - prof. dr. Paolo Rago (Itali).

- "Onufër Qiprioti, ikonograf i shquar i shek. XVI-XVII" - dr. Mustafa Arapi.

- "Imazh dhe fuqi në periudhën e Andronikut II Paleolog; patronazhi perandorak në trevat perëndimore të rrugës Egnatia" - Anna Christidou (Athinë) dhe prof. dr. Kostas Giakoumis.

Në përfundim mund të themi se konferenca kishte një larmi temash, të cilat plotësonin imazhin e kërkuar nga organizatorët dhe pjesëmarrësit. Kjo u shpreh dhe në diskutimet e shumta, të cilat pasqyruan vlerësimet dhe arritjet e temave të prezantuara si dhe la të hapur dhe në mënyrë të pashmangshme nisjen e një procesi të ri për organizimin e një konference tjetër shkencore, por këtë radhë më të zgjeruar dhe disaditore. Ky vendim erdhi si pasojë e interesimit të madh të pjesëmarrësve, temave të reja të paraqitura, fakteve të reja të nxjerra nga hulumtimet historike si dhe stimulimi pozitiv që i ka bërë njerëzve të kulturës dhe të artit kanidatura e pranimit të qytetit të Beratit nga komisioni kombëtar i UNESCO-s.

Aktet e kësaj Konference Shkencore Ndërkombëtare do të botohen sipas një vendimi të organizatorëve në një përmbledhje të veçantë, e cila do të botohet shumë shpejt.

Përgatiti: ark. rest.  
Gentian (Joan)  
Stratobërdha

*Konferenca rinore e Mitropolisë së Beratit*

## Të jemi të pëlqyer nga Perëndia

Rinia orthodhokse e Mitropolisë së Beratit ishte e ftuar edhe këtë fundvit në konferencën me temë "Qëllimi i jetës sonë", një aktivitet i organizuar nga Zyra Kombëtare e Rinisë Orthodhokse. Rreth 80 të rinj të ardhur nga shumë enori të kësaj dioqeze ndoqën me entuziazëm veprimtaritë e ndryshme shpirtërore dhe kulturore. Tepër interes u tregua për bisedat shpirtërore, të cilat krijuan mundësi tek të rinjtë për t'u njohur me njëri-tjetrin dhe për të folur rreth aspekteve të ndryshme të besimit.

Referati i parë u mbajt nga Mitropolit i Beratit, Ignati, rreth temës për qëllimin e jetës si të krishterë orthodhoksë. "Disa njerëz mendojnë për bukurinë fizike dhe për pasurinë. Por bukuria vyshket dhe pasuria kalbet. Nëse i përkushtohemi tërësisht botës, kemi për të mbetur të pëlqyer vetëm nga bota. Nuk duhet të harrojmë se për ne

njerëzit ka rëndësi të jemi të pëlqyer nga Perëndia" - theksoi gjatë fjalës së tij, Imzot Ignati.

Referati i dytë u mbajt nga drejtori i Zyrës së Katekizmit z. Miron Çako, i cili foli për misterin e Kungatës Hyjnore. Ai u bëri thirrje të rinjve të parapërgatiten për të ma-

rrë trupin dhe gjakun e Krishtit, nëpërmjet Kungatës, sepse ky mister na lidh drejtpërdrejt me Krishtin, duke u bërë një me Të. Këto tema u shoqëruan me pyetje e diskutime nga vetë të rinjtë.

*Korresp. i gazetës "Ngjallja"*



*Konferenca rinore e Mitropolisë së Gjirokastrës*

## Të rinjtë të jenë sa më aktivë në jetën e Kishës

Nga 1-3 dhjetor u zhvillua në Përmet konferenca rinore e Mitropolisë së Gjirokastrës, me një pjesëmarrje të gjerë të të rinjve dhe të rejave orthodhokse nga enoritë e kësaj Mitropolie. Kjo konferencë priti edhe të rinj nga Tirana dhe Elbasani, nxënësit e liceut kishtar "Kryqi i nderuar" në Gjirokastrë dhe të shkollës së mesme në Mesopotam të Sarandës, të cilët morën pjesë aktive në të gjitha veprimtaritë shpirtërore dhe kulturore që u organizuan gjatë tri ditëve, duke e çuar afërsisht në 200 numrin e pjesëmarrësve, si rrallëherë në të tilla konferenca.

Gëzimi dhe entuziazmi i të rinjve mbushi vakuumin e këtij qyteti të vogël, por shumë mikpritës. Ashtu sikurse në konferencat e zhvilluara edhe nëpër dioqezat e tjera, tema ishte: "Qëllimi i jetës sonë si të krishterë orthodhoksë", që u referua nga Motër Thekla. "Qëllimi i jetës sonë gjendet brenda Shkrimit të

Shenjtë. Ne duhet t'i ngjajmë Perëndisë. Kjo dhuratë lidhet ngushtë me zgjedhjen tonë, sepse qëllimi i vërtetë është Parajsa, atdheu ynë i humbur dhe bashkimi me Perëndinë." - theksoi ajo.

Referati i dytë u mbajt nga z. Dhimitër Vavaka, me temë "Enoria dhe jeta brenda saj". Referuesi u ndal në disa nga pikat kryesore për mënyrën se si duhet të funksionojë një enori dhe çfarë duhet të bëjmë ne sot për ta pasuruar atë. "Të bashkohemi të gjithë në Kishë dhe të marrim pjesë në misteret e saj, të bashkëpunojmë për të funksionuar enoria jonë duke mbledhur materiale për shërbime të ndryshme, të ndihmojmë anëtarët e enorisë për të plotësuar nevojat shpirtërore dhe materiale, të hapim qendra rinore për të marrë edukatë shpirtërore dhe për të mësuar teknologjitë e reja, si edhe të vijnë anëtarë të rinj në mënyrë që ata të bëhen aktivë në enorinë tonë. Të gj-

tha këto që Zoti Krisht të jetë gjithçka për të gjithë ne".

Lutjet e përbashkëta ishin një tjetër aktivitet i rëndësishëm i kësaj konference, duke filluar me Shërbesën e Paraklisit të premtën. Të shtunën, në kishën e Shën e Premtës u vazhdua me Shërbesën e Mëngjesores, ndërsa në kishën e Shën Nikollës u zhvillua ajo e Mbrëmësore.

Lojërat e ndryshme argëtuan të gjithë të rinjtë, bashkë me këngët e vallet karakteristike përmetare.

Të dielën në mëngjes, pjesëmarrësit ishin të ftuar nga Mitropolit i ri i Gjirokastrës, Dhimitri, për të ndjekur Liturgjinë Hyjnore në kishën "Metamorfoza e Shpëtimtarit. Në fund të saj, Hirësi Dhimitri i takoi të gjithë të rinjtë duke u kërkuar atyre të jenë sa më aktivë në veprimtaritë e Kishës dhe të japin kontributin e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të saj.

## Traditë e bukur me ish-studentët e Akademisë Teologjike

*Është kthyer tashmë traditë dita e enjte, për pjesën më të madhe të ish-studentëve të diplomuar në Akademinë Teologjike "Ngjallja e Krishtit" dhe të punësuar në qendra të ndryshme të Kishës sonë në Tiranë, që të mblidhen së bashku në pasdite për studim biblik. Ky studim drejtohet nga misionarët tanë shumë të përkushtuar, të cilët kanë ardhur për të ndihmuar Kishën Orthodhokse në Shqipëri, duke dhënë një shembull apostolik tek të rinjtë dhe të gjithë besimtarët shqiptarë.*

*Për këtë vit, takimi filloi me dhjakon Hektorin e në vazhdimësi do të jetë z. Nathan Hoppe. Studimi bazohet mbi Shkrimin e Shenjtë e më pas do të përqendrohet në librin e teologut të famshëm Aleksandër Shmeman, "Jeta e botës".*

*Diskutimi i parë ishte mbi Ungjillin sipas Llukait, në paravolitë e gjykatësit të padrejtë, e fariseut dhe tagrambledhësit, i riu pasanik dhe i verbri i Jerikos. Secila prej këtyre paravolive përcillte mesazhe të pafundme dhe çështje për diskutim. I këndshëm ishte diskutimi, pyetjet e ngritura dhe përjetimi shpirtëror. Ajo që të bën përshtypje dhe që ia vlen për t'u përgëzuar është dëshira, gatishmëria, prania dhe këmbëngulja e të tjera virtyte, të cilat nxisin pjesëmarrësit të marrin iniciativë të tilla. Udhëtimi ynë i përvitshëm ka nisur, prandaj le të kemi këmbëngulje në lutje, në vepra të mira, të kemi kërkesë për Mbretërinë e Qiejve, të kemi veprën e Farisuet dhe përvitshëm të Tagrambledhësit, sensibilitetin e të qenit fëmijë në jetën tonë të përditshme, në mënyrë që të trashëgojmë atdheun e humbur.*

*Takimi u mbyll me një koktejl i përgatitur me shumë dashuri nga dhjakonesha Ekaterinë.*

*Elena Krakulli*

6 JANAR

## Epifania e Zotit Krisht Uji i Bekuar

Edhe Joani ishte veshur me lesh gamileje, dhe kishte brez të lëkurtë rreth mesit të tij dhe hante karkaleca e mjaltë të egër. Edhe predikonte, duke thënë: Prapa meje vjen më i forti se unë, të cilit s'jam i zoti të ulem e t'i zgjidh rripin e këpucëve. Unë ju pagëzova me ujë, po ai do t'ju pagëzojë me Shpirt të Shenjtë.

Edhe në ato ditë erdhi Jisui nga Nazareti i Galilese dhe u pagëzua nga Joani në Jordan. Edhe menjëherë, duke dalë nga uji, pa qiejt duke u hapur dhe Shpirtin e Shenjtë si pëllumb duke zbritur mbi të. Edhe erdhi një zë nga qiejt: Ti je Biri im i dashur që e kam pëlqyer.

Marku 1:6-11



*Kur pagëzohesh në Jordanin, o Zot për ne, atëherë falja e Shën Trinisë kudo u shfaq, se zëri i Atit po na dëshmonte për Ty faqeza dhe Bir të dashur të tij po të quante, edhe Shpirti i Shenjtë si një pëllumb, vërtetonte çdo fjalë me siguri. O Krisht Perëndi, që u shfaqe dhe ndriçove botën, lavdi më Ty!*

(Përlëshorja)

*U Shfaqe me lavdi, në tërë botën, edhe Drita Jote ndriçoi mbi ne sot, pra të himnojmë me kuptim: Erdhe dhe zbulove vetveten, O Dritë e Paafuarshme.* (Shkurtorja)

\*\*\*

*Zëri i Zotit po thërret mbi ujërat e thotë: Ejani të gjithë, merrni Shpirtin e urtësisë, Shpirtin e kuptimit dhe Shpirtin e frikës së Perëndisë, Zotit Jisu Krisht që u shfaq në Jordan.*

*Sot bekohet natyra e ujërave, sot Jordani po hapet më dysh dhe valët e tij po qëndrojnë, duke parë Zotin të pagëzohet.*

*Si njeri erdhe në lumë, o Mbreti ynë Jisu Krisht, edhe kërkon të pagëzohesh si shërbëtor për mëkatet tona, nga dora e Profetit (Joan), O Njeridashës.*

(Himne të Bekimit të Madh të Ujit)

### Nuk shërohet e keqja me të keqe

Të kërkojsh gjoja ta shërosh tjetrin nëpërmjet zemërimit tënd përmban rrezikun të sëmuresh dhe të vdesësh ti vetë! "Askush nuk shëron të keqen me të keqe", na thërret shën Joan Gojarti (Is ton Agion Ioannin 51.3). "E mira nuk është mirë, kur nuk bëhet mirë", shton shën Grigor Theologu (Apothegmata 2.46), "pasi nuk gjuajmë të mirën me mënyrë të keqe" (Omelia 42, Sintaktirios 13). Nëse ti vendos para syve të tu teneqe tepër të ndryshkur ose flori tepër të shkëlqyer, të dyja këto e pengojnë njësoj shikimin. Me të njëjtën mënyrë verbojnë shkaqet e zemërimit, të palogjikshme a të logjikshme në dukje (Shih Kasianoit, Pros Kastora episkopon, Peri Orgis).

Vëllai i madh i plangprishës kishte të drejtë që u nxe. Gjërat që i ndezën zemërimin ishin reale, jo hiperbolike. Vëllai i tij kishte pikëlluar babanë e dhembshur,

kishte ikur larg dhe kishte ngrënë pasurinë prindërore, duke u rrokullisur në mëkatin "me lavire", por ati i theri viçin e zgjedhur, ndërkohë që ai vetë, biri "korrekt", punonte me sedër, kishte vetëpërmbytje dhe thjeshtësi. Nuk kishte qoftë edhe një keq të vetëm, megjithëse punonte me bindje vite të tëra... Kishte të drejtë që kishte ngulur këmbë - luftonte dhe mbronte të drejtën. Kishte të drejtë që i "dhembte për të drejtën", sepse shkatërrohej rendi ligjor; duhej të dëbohej mizori. Kishte të drejtë inatçiu; a është e mundur ta mohojë njeri? Kishte të drejtë, por ama nuk kishte dashuri! E kundërta ndodhte me babanë e tij. Kështu, biri i parë mbeti mbrapa. E parakaloi dashuria e atit, e la mbrapa pendimi i fajtorit. Kishte shumë avantazhe, veçse privohej themeli dhe baza e tyre, dashuria, prandaj të "mirat" e tij ishin në hava. (Luk. 15. 11-32).

### Kërko shpëtimin dhe të mirën e të afërmit tënd

Shën Simeoni, Theolog i Ri, flet për dy shpirtra që kishin kapur majat. Ndoshta nuk gabohemi, po të themi se një lartësi të tillë e kishte arritur ai vetë, por për arsye përu-lësie, fitoret e tij i përshkroi tek njerëz të panjohur. Ja çfarë na zbulon oshënari, duke befasuar dembelizmin tonë:

"Pashë një tjetër, i cili ngazë-llohej për ata që luftonin dhe kishin sukses dhe priste të mirën e tyre aq shumë, sa të thuash se ky më tepër sesa ata do të merrte shpërbllimin e virtyteve dhe lodhjeve; ndërsa për ata që binin dhe qëndronin me këmbëngulje në mëkat, i vinte keq dhe rënkonte aq shumë, sa të thuash se vërtet ky vetëm do të detyrohej të kërkonte ndjesë për të gjithë këta dhe do të dorëzohej në Ferr. Dhe pashë një tjetër, që dëshironte dhe donte shpëtimin e vëllezërve të tij, saqë shumë herë i

lutej Perëndisë njeridashës me lotët e nxehtë nga zemra, ose që edhe ata të shpëtoheshin, ose dhe ky të dënohej bashkë me ta, sepse nuk donte aspak që të shpëtonte vetëm veten e tij, pasi kishte predispozicion imitimitin e Perëndisë [shih Joan. 10. 15] dhe të Moisiut [shih Eks. 32. 32]" (Katihisis 8).

Stareci Zosima i Dostojevskit na nxiti: "Nëse mundesh të marrësh përsipër krimin e të akuzuarit që gjykon brenda zemrës sate, ta bësh menjëherë, dhe të kesh ti dhimbje për llogari të tij" (Vëllezërit Karmanzov, Libër. 6, 3, 8).

Ka mjaft raste në Jetë Shenjtore ku u shpif për njerëzit e Perëndisë për mëkate të rënda dhe megjithëse i dinin fajtorët e vërtetë nuk i zbuluan, duke parapëlqyer kështu të dënohen vetë në vend të tyre.

Atë Justin

## Plotësohet Sinodi i Shenjtë

### - Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ka edhe 3 episkopë të rinj -

Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, të datës 11 nëntor 2006, u vendos që të ngrihen në gradën episkopale 3 arkimandritë të Kishës sonë:

Arkimandrit Dhimitër Sinaiti, 66 vjeç, u caktua Mitropolit i Gjirokastrës (ku ka shërbyer në 15 vitet e fundit si zëvendësmropolit. Ai ka qenë pjesëtar i vëllazërisë së njohur murgërore të Sinait, në Egjipt, ku mund të përmendet edhe si një nga studiuesit dhe kataloguesit e dorëshkrimeve të famshme që u zbuluan aty, mes të cilëve edhe dorëshkrimi më i vjetër që njihet i Dhiatës së Re). Në datën 16 nëntor u krye në Kishën-katedrale “Ungjillëzimi i Hyjlindëses”, në Tiranë, nga Kryepiskopi Anastas, Hirësi Ignati dhe Hirësi Joani shërbesa e dorëzimit në episkop e Arkimandritit Dhimitër.

Liturgjia dhe Ceremonia e Fronëzimit të Mitropolitit të Gjirokastrës Hirësi Dhimitrit, u bënë në dt. 26.11.2006, në kishën e Kryeengjëjve në Gjirokastrë. Ajo u krye në shqip dhe greqisht, sipas specifikës së kësaj mitropolie, gjë që dëshmon harmoninë dhe respektin e ndërsjellë mes besimtarëve.

-Arkimandrit Nikolla Hyka, 35 vjeç, i cili mori titullin Episkop i Apollonisë. Në datën 19 nëntor u krye në Kishën-katedrale “Ungjillëzimi i Hyjlindëses”, në Tiranë, nga Kryepiskopi Anastas, Hirësi Ignati, Hirësi Joani dhe Hirësi Dhimitri shërbesa e dorëzimit në episkop e Arkimandritit Nikollës.

-Arkimandrit Andon Merdani, 37 vjeç, i cili mori titullin Episkop i Krujës. Në datën 21 nëntor u krye në Kishën-katedrale “Ungjillëzimi i Hyjlindëses”, në Tiranë, nga Kryepiskopi Anastas, Hirësi Ignati, Hirësi Joani, Hirësi Dhimitri dhe Hirësi Nikolla, shërbesa e dorëzimit në episkop e Arkimandritit Andon Merdani.

(Vijon në faqen 8)



Në fotot (nga lart poshtë): Çaste nga hirotonia e Hirësi Dhimitrit, nga hirotonia e Hirësi Nikollës dhe nga hirotonia e Hirësi Andonit.

### Nga Fjala e Kryepiskopit Anastas në dorëzimin e Hirësi Dhimitrit

*Hirësi, Mitropolit i zgjedhur i Gjirokastrës  
I dashur vëlla më Krishtin, Dhimitër;*

*“Edhe kemi këtë thesar në enë baltë, që të jetë teprimi i fuqisë nga Perëndia dhe jo nga ne” (2 Kor. 4:7).*

...I shërben Kishës për shumë vite dhe në detyra të ndryshme. Njëkohësisht gjatë 15 viteve të fundit, shërben në mënyrë vullnetare si Protosingjel i Mitropolisë së Shenjtë të Gjirokastrës. Që në vitet e para të rrugëtimit tënd në Shqipërinë e rrënuar nga pushteti ateist, more pjesë në sprovat, hidhërimet, shpresat tona dhe luftovetë së bashku me ne për riungjillëzimin e popullit të vuajtur dhe ringritjen e enorive orthodhokse në zonën e gjerë të Mitropolisë së Gjirokastrës...

Fjalja më e rëndësishme, që do dëgjohet gjatë kohës së dorëzimit tënd është: “Hiri Hyjnor, që i shëron të gjitha lëngatat dhe i plotëson të gjitha mungesat, të dorëzon ty priftin perëndidashës Dhimitër, Mitropolit të Mitropolisë fort të shenjtë të Gjirokastrës. Le të lutemi për atë, që të vijë tek ai hiri i Shpirtit të Tërëshenjtë”. Me këtë siguri të padenjësishme personale, por në të njëjtën kohë të mëshirës dhe të fuqisë së Perëndisë, që na ngarkon përgjegjësinë episkopale, përparo me qetësi, me guxim, në kryerjen e detyrës tënde baritore.

Dispono të gjitha fuqitë e tua për riungjillëzimin e popullit: me aktivitetin e pandërprerë, predikimin, kryerjen e Mistereve, këshillat personale. Për disa dhjetëvjeçarë, ky vend ishte privuar nga besimi në Shpëtimtarin Krisht dhe nevojat nuk mund të mbulohen lehtë në pak vjet. Le të jemi dashamirës ndaj gjendjes në të cilën ndodhet populli. Pjesa e leximit nga apostulli, që do të dëgjohet pak më vonë, është shumë aktuale. “Pra si do të thërrasin atë, të cilin nuk e besuan? Edhe si do të besojnë atë që nuk e dëgjuan? Edhe si do të dëgjojnë pa pasur predikues?” (Rom 10:14).

## Plotësohet Sinodi i Shenjtë

(vijon nga faqja 7)

Hirësi Nikolla dhe Hirësi Andoni janë shqiptarë nga brezi i klerikëve të rinj të formuar në Akademinë Theologjike Orthodhokse “Ngjallja e Krishtit”, Durrës dhe në vazhdim kanë kryer me rezultate të shkëlqyera edhe studime të specializuara theologjike jashtë vendit.

**Sinodi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë tashmë përbëhet nga:**

†**Kryepiskopi Anastas, Kryetar; Mitropoliti i Beratit Ignati, Mitropoliti i Korçës Joani, Mitropoliti i Gjirokastrës Dhimitri, Episkopi i Apollonisë Nikolla, Episkopi i Krujës Andoni; Kryesekretar i Përgjithshëm, Protopresviter Jani Trebicka.**



Çast  
nga dita  
e Fronëzimit  
të Mitropolitit  
të Gjirokastrës,  
Hirësisë  
së Tij  
Dhimitrit.

### Nga Fjala e Kryepiskopit Anastas në dorëzimin e Hirësi Nikollës

*Hirësi, Episkop i zgjedhur i Apollonisë, Biri im Nikolla,*

...Në këto vite të jetës sate pranove në mënyrë të habitshme, dhuratat e Perëndisë njëra pas tjetrës. U linde para 35 vjetësh dhe i kalove vitet e fëmijërisë në një kohë, kur Shqipërinë e kishte mbuluar errësira e dendur e ateizmit. Por Perëndia jo vetëm, që të udhëhoqi në kohë në vitet e tua të rinisë në botën e ndritshme të Mbretërisë së Dashurisë, por edhe të ftoi Ta ndjekësh.

Studiove në Akademinë Theologjike “Ngjallja e Krishtit”, u bërë klerik, vazhdove studimet e mëtejshme në Fakultetin Theologjik të Athinës me rezultate të shkëlqyera. Fitove me anë të jetës sate të paqortueshme, me sjelljen tënde fisnike dhe korrektesën e madhe, vlerësimin dhe dashurinë e profesorëve dhe bashkëstudentëve të tu. Dhe sot Kisha të nderon me gradën episkopale. “Sepse me hir jemi të shpëtuar me anë të besimit - na thekson pjesa e sotme e leximit nga Apostulli - dhe kjo nuk është prej jush, po është dhuratë e Perëndisë. Jo prej veprash që të mos mburret ndonjë”. (Efes. 2:8)

...Të gjitha këto duhet të kenë bosht të qëndrueshëm “në Jisu Krishtin”. Kjo është e fshehta e episkopit Orthodhoks, që jeton më Krishtin. Na frymëzon përjetimi i apostull Pavlit: “Dhe nuk rroj më unë, po Krishti rron tek unë” (Gal. 2:20). Të vetëm ne, nga ana jonë, nuk kemi asgjë thelbësore për të thënë. Episkopi si pasues i Apostujve, duhet vazhdimisht të ketë ndjesinë se e ka dërguar dikush tjetër; i dërguari kryesor i Perëndisë, Krishti. “Sikundër Ati më ka dërguar mua, edhe unë po ju dërgoj juve” (Joan 20:21-22)...

Dhe një gjë të fundit biri im. Dy episkopët e Shqipërisë, që kishin para teje titullin e episkopatës dikur shumë të famshme të Apollonisë, qenë njerëz të bekuar në mënyrë të veçantë. Si episkopi Irine, ashtu dhe Episkopi Kozma. Të dy në vitet e persekutimit të egër të besimit, qëndruan të patundur, rezistentë si diamantë dhe shkëlqyen brenda errësirës së thellë me besimin dhe aktivitetin e tyre të pareshtur. Përkujdesu pra edhe ti që të nderosh titullin e Episkopit të Apollonisë, që merr sot, me jetë shenjtërie, krijimtarie, “të mbushur me përdëllim dhe punë të mira”.

### Nga Fjala e Kryepiskopit Anastas në dorëzimin e Hirësi Andonit

*Hirësi, Episkop i zgjedhur i Krujës, Biri im Andon,*

...U linde në një vend, në të cilin disa të pamend kërkuan të shuanin dritën e Diellit të Drejtësisë. Por ti e kërkove nga vitet e rinisë sate; njohe Krishtin dhe u fute në mënyrë të ndërgjegjshme në Kishën e Tij. Në vazhdim vendose t’i përkushtosh të gjithë jetën tënde, duke ndjekur Zotin tonë. Studiove theologji, si në Akademinë tonë “Ngjallja e Krishtit” ashtu edhe në Fakultetin Theologjik të Universitetit të Athinës, me rezultate të shkëlqyera. U dorëzove klerik, duke e nderuar priftërinë tënde dhe duke fituar vlerësimin, dashurinë, besimin e atyre që të njohën.

Dhe sot, Kisha të fton të bëhesh Episkop, detyrë që nënkupton një nder të madh, por edhe përgjegjësi të madhe... Episkopi, siç shpjegon shën Ignat Hyjmbajtësi, është “në vend” dhe “sipas tipit të Krishtit” (Magna IV, I). Nuk vepron kurrë duke u nisur nga vetja. E di se është “shërbëtor i Krishtit dhe ekonom i fshehtësirave të Perëndisë”. Zoti ynë në shëmbëlltërinë e tij të njohur për kujdestarin besnik, e lidhi besnikërinë e tij me vigjilencën dhe urtësinë. (Luk. 12:35-48)...

Hyrja jote, i dashur biri im, në shërbesën episkopale, përkon me festën, sipas traditës kishtare, të Hyrjes së të Tërëshenjtës Nënës sonë në tempull. Virgjëresha është përfundimisht vetë Tempulli i gjallë dhe i përsosur, në të cilin bëhet fjalë të banojë Perëndia. Të gjithë ne, që duam të quhemi bij të Tij, dhe veçanërisht, sa shërbejmë nga një pozitë kishtare e përgjegjshme në misterin e shpëtimit, duhet të ndërgjegjësohemi se para së gjithash, ftohemi të bëhemi edhe ne vetë “tempuj të Perëndisë së gjallë...” Të ecësh gjithmonë me predispozitë lavdërimi, në ngazëllim, sipas shembullit të Nënës së Zotit. “Shpirti im madhëron Zotin dhe mendja ime u ngazëllua më Perëndinë, shpëtimtarin tim”...

Edhe Shpirti i Shenjtë banoftë brenda teje, të përforcoftë në besim, dëlirëssoftë jetën tënde, le të frymëzojë mendimin, vendimet, veprimet e tua. Deri në atë ditë që Zoti do të të thërrësë pranë Tij, që të hysh, si kujdestar besnik i mistereve të Perëndisë, në gëzimin e Mbretërisë së Tij.

*Një jetë duke shërbyer me besnikëri në kishë*

## Ikonom atë Theodor (Todi) Toni (1895-1981)

Lindi më 1895, në fshatin Gradishtë të rrethit Lushnjë, nga një familje vllahe e ardhur aty rreth viteve 1810-1820 nga Voskopoja. Mësimet e para në shqip e greqisht i mori në Manastirin e Ardenicës. Në vitin 1915 vijoi të merrte mësimet në Korçë në fushën e historisë dhe gjeografisë. Më 1916 është mësuesi që hapi të parën shkollë shqipe në fshatin Gërmenj të Lushnjës, fshat që është i vendosur në vargun e kodrave të buta, që fillojnë në Gradishtë e përfundojnë në Sulzotaj. Më vonë, në vitin 1919, me dëshirën e tij dhe me këmbënguljen e këshillit të kishës dhe veçanërisht të epitropit Gaqi Sterjo (Naçi), ai u dërgua në Janinë për të mësuar mbi teologjinë Orthodhokse. Më pas u kthye në fshatin e lindjes ku u

hirotonis dhjakon e më pas prift. Nga viti 1923 i shërbeu kishës deri në vitin 1967, kur regjimi komunist rrafshoi dhe kishën shumëvjeçare të Shën Minait, si shumë objekte të tjera të kultit.

Përveç fshatit Gradishtë i banuar nga vllahë, ai shërbeu dhe në fshatrat Fierseman, Gungës, Koriye dhe Sh. Gjergj, të banuara nga orthodhoksë. Në këtë enori ekzistonin dhe kishat e Shën Ilias, Shën Gjergjit dhe Shën Kollit. Marrëdhëniet e atë Theodorit me besimtarët ishin shumë të mira, i trajtonte të gjithë të barabartë dhe me respekt. Atë Theodori shquhej për seriozitetin dhe korrektësinë në detyrë. Dallohej për urtësinë e gjykimit të gjërave, kishte horizont për shumë fusha në shkencat shoqërore dhe

ekzakte. Gëzonte respektin e kolegëve të tij si të atë Konstandinit, i cili shërbente në qytetin e Lushnjës, atë Lluka Danit, i Krutjes dhe atë Sakos, i Divjakës. Ashtu si në gjithë Shqipërinë feja edhe shërbëtorët e saj shiheshin jo me sy të mirë dhe propagandohej kundër tyre. Edhe atë Theodori nuk i shpëtoi dot kësaj përndjekjeje. Kështu ai u izolua për afro dy vjet e gjysmë (1949-1951) në Manastirin e Ardenicës nga pushteti i asaj kohe.

Gjatë viteve 1951-1953 shërbeu në kishën e fshatit Këmishtaj. Në vitin famëkeq të genocidit komunist kundër fesë, 1967 ai u izolua në shtëpinë e tij. I mbyllur dhe i rrethuar nga dashuria dhe respekti jo vetëm i familjes, por edhe i shumë

besimtarëve të moshuar, të cilët e vizitonin për t'i dhënë kurajë për atë që i ndodhi atij dhe të tjerëve, me besimin se dita e bekuar që të ringrejë Shën Minain do të vinte përsëri. Atë Theodori i kaloi vitet duke lexuar ato libra të paktë fetarë që kishte në shtëpi, duke lotuar mbi to. Në vitin 1977 ai u verbua. Fjeti më Zotin me shpresën dhe besimin tek Ai.

Atë Theodori ndërroi jetë më 18 mars 1981, i përcjellë me nderim e respekt nga shumë njerëz të ardhur jo vetëm nga fshatrat përreth, por edhe nga shumë qytete të Shqipërisë si Lushnja, Fieri, Berati, Durrësi, Tirana etj.

*Spiro Toni (i biri), Durrës*

### Shënime historike

## Dioqeza e Gjirokastrës

Dioqeza e Gjirokastrës përbëhet nga episkopatat e vjetra të Drinupojës, të Finiqit, të Butrintit, të Anhezmit dhe të Himarës, të cilat për arsye të pakësimit të popullatave të tyre (orthodhokse) në të shkuarën, janë bashkuar në një dioqezë me qendër Gjirokastrën. Këtu po japim disa shënime historike në bazë të burimeve të pakta që kemi.

1. Episkopata e Drinupojës, e cila njihet edhe me emrat e Adrianopojës dhe e Justinianopojës, e kishte qendrën në qytetin e vjetër të Drinupojës, që gjendej midis fshatrave të sotëm të Dropullit, Goricë dhe Terihat, në vendin ku edhe sot duken ca gërmadha shtëpish të vjetra dhe kishash, si dhe një kishë e ndërtuar mbi ca themele ciklopike, me emrin e Metamorfozës së Shpëtimtarit. Kjo kishë ka qenë katedralja e episkopatës.

Në kohët e para të krishterimit, qyteti i Drinupojës ishte i madh dhe i pasur. Ypati, episkopi i saj, ka lozur një rol të madh në sinodin lokal të Epirit, më 516 pas Krishtit. Mirëpo më 558 u prish krejt nga Gotët dhe banorët u shpërndanë. Froni epi-

skopal u transferua atëherë në një fshat të Dropullit që quhej Kladianë dhe që më vonë mori emrin Episkopi (episkopatë). Këtë qendër të re të episkopatës perandori Aleks Komneni e pajisi me privilegje dhe dhurata të mëdha pas kërkesës së episkopit të atëhershëm Metodit, i cili ishte njeri i ditur dhe i urtë. Deri më sot gjendet në atë fshat kisha katedrale e kësaj episkopate. Por

edhe kjo qendër u prish në kohën e kryqëzatave. Kështu, froni episkopal u zhvendos në Kardhiq, afër kishës së Shën Kollit të Manastirit të Cepos. Kjo kishë u përdor si katedrale për episkopatën dhe ish ndërtuar nga perandori Konstandin Pogonati, më 668 pas Krishtit.

Më 1183 Andronik Paleologu e ripërtëriu, e zmadhoi dhe e zbukuroi, duke e mbuluar me plumb dhe

duke i dhënë mjaft privilegje. Në Manastirin e Cepos qendra episkopale mbeti gjer në vitin 1395. Atë vit qeveritari i atëhershëm i Gjirokastrës Gjon Yenevisi e transferoi në Gjirokastrë, ku ka qëndruar deri më sot.

*(Vijon në numrin e ardhshëm)*

Botuar në Jeta Kristiane, 1944

Dhimitër Beduli



## Dobësitë tona të çmuara

*“Lum njeriu që njeht dobësinë e tij. Pasi kjo njohje është themeli, rrënja, parimi i çdo mirësie. Kur njeriu ka mësuar dhe ndier dobësinë e tij, nuk e përqendron shpirtin në kotësi që errëson njohjen, por e ruan në vetvete vigjilencën si një thesar.”*

(Shën Isaak Siriani)

Këto fjalë të cilat na vijnë nga një murg i shekullit të VII-të, duken pa dyshim të pakuptueshme për njeriun modern, i cili duke u vendosur në mënyrë të ndërgjegjshme apo jo, nën slloganin ‘*Vullneti i fuqisë*’ të Niçes, i cili përhapet me forcën që mbart në të gjitha fushat si ajo ekonomike, ushtarake, industriale, teknike, ky njeri është i preokupuar deri në obsesionin që ka për të rritur fuqinë financiare, fizike, seksuale etj.

Në fakt, si do të mund të ishte i lumtur një njeri i “formatuar” sipas normave të diktura nga mënyrat e jetesës dhe nga mentalitetet e sotme duke konstatuar dobësinë e tij? Pa dyshim, përveç kësaj ai nuk do të ngurronte së pyeturi se cila do të ishte kjo udhë e pabesueshme nëpërmjet së cilës njohja e dobësive tona do të bëhet themeli i çdo virtyti... Asnjë nga fjalët e lartpërmendura nuk janë për atë të panjohura, dhe për më tepër, nëse këto fjalë do t’i lexonte njeriu i kohëve tona do të ishte e vështirë t’iu nxirrte kuptimin, kaq shumë janë larguar nga tradita e krishterë mentalitetet dhe fjalori i kohëve moderne. Një përkthim i vërtetë ndihet i nevojshëm për të ripërcaktuar këto nocione dhe të caktojë kuptimin origjinal të tyre sipas mendimit të autorit dhe një perspektivë shpirtërore. Dobësia për të cilën po flasim këtu nuk i referohet vetëm papërsosmërive individuale si psikologjike apo morale, por gjithashtu dhe mbi të gjitha pafuqisë dhe kufizi-

meve tona ontologjike të qenies njerëzore të rënë, të ndarë e të larguar nga Krijuesi i saj - kjo është ajo që Paskali e quante mjerimin e njeriut: “Ajo që është e natyrshme të kafshët, tek njerëzit quhet mjerim, nga ku ne njohim se sot natyra e tij është njësuar me atë të kafshëve, ka rënë nga natyra më e mirë e cila më parë ishte e tija. A nuk do të ishte fatkeq ai që nuk është mbret ose ndryshe një mbret pa asgjë?”

Madhështia e njeriut buron pra, sipas Paskalit nga mjerimi i tij, d.m.th. nga ndërgjegjësimi i dobësisë së tij ontologjike, e cila bën që kafsha njerëzore nuk është e nuk do të jetë kurrë i kënaqur nga gjendja e tij deri sa të ketë gjetur natyrën e tij të vërtetë, e cila është hyjnore në imazhin dhe ngjashmërinë e Krijuesit të tij. Ja pra pse mistikët e çdo kohe dhe të çdo tradite bien dakord të pohojnë se nuk ka fatkeqësi më të madhe që mund ta cënojë një njeri sesa vetëkënaqësia, pra të jesh i kënaqur me veten tënde.

*“I drejti që nuk është ndërgjegjësuar për dobësinë e tij ecën mbi majën e brishtë - na paralajmëron shën Isaak Siriani. Ai nuk është larg rënies dhe luanit shkatërrues, dua të them demonit të krenarisë”*

Të kënaqesh me veten, nënkupton dremitje në rrugën që bën krijesa jo e përsosur drejt Krijuesit të saj, që vetë është i përsosur dhe përveç kësaj dremitja sjell herët a

vonë rënien fatale të njeriut të verbuar nga një imazh shumë lajkates që ka për veten.

Në fakt një i sëmure nuk duhet të ndalojë pa asnjë pretekst kurimin e tij derisa të shërohet plotësisht, përndryshe e keqja do ta vinte poshtë dhe gjendja e tij do të rëndohej duke e privuar kështu nga efektet mirëbërëse të marra më parë.

Gjithashtu edhe njeriu i cili ecën në rrugën e shërimit shpirtëror - dhe në jemi të gjithë ose duhet të jemi të gjithë - cilido qoftë stadi ku është duhet të ruajë gjithmonë në mendje ndjenjën dhe ndërgjegjen e gjallë të papërsosmërisë së tij - thënë ndryshe të dobësisë së tij të dyfishtë, personale dhe në të njëjtën kohë ontologjike - pasi tërësia e procesit të shërimit qëndron në njohjen e së keqes personale.

Nëse do ta krahasonim Mbretërinë e Qiejve me një shkallë, ky krahasim nuk është vetëm për shkallët e njëpasnjëshme, por edhe për vetë faktin se mbi një shkallë nuk është e mundur të ndalesh në mes të rrugës: ose ngjitemi ose zbrësim.

Duke këmbëngulur mbi domosdoshmërinë e njohjes së dobësisë sonë dhe të ruajmë brenda nesh ‘*vigjilencën si një thesar*’, shën Isaak Siriani na bën të ditur rrezikun që na kërcënon kur - nga neglizhenca, indiferenca apo kotësia - harrojmë se të gjithë vuajmë nga e njëjta sëmundje, e cila është sëmundje e mirëfilltë e gjindjes njerëzore, dhe se i vetmi qëllim real i jetës sonë tokësore, i cili përmbledh të gjitha aspektet e ekzistencës sonë, është të shërojmë të keqen që ndodhet në natyrën e njeriut të rënë, thënë ndryshe, të fitojë mbi vetë vdekjen me ndihmën dhe në shembullin e Shpëtimtarit tonë.

Ndërgjegjësimi për dobësitë tona nuk është veçse pasoja natyrale e një vizioni të qartë për veten, i cili lind në mënyrë krejt natyrale përulësinë, ‘*virtutin i cili përmbledh gjithçka tek vetja*’ - na kujton shën Isaak Siriani. Amin

Nga **Prof. Viorel Stefanianu**  
Material i shkëputur nga Buletini  
*Shën Joan Kasiani*,  
Paris, shtator 2006, fq.16

Përktheu: Eleni Pani

## Kalendari i Liturgjive Hyjnore, JANAR 2007

**1 E Hënë † Rrethprerja e Zotit tonë Jisu Krisht.**

Vasili i Madh.

3 E Martë Pr. Malakia.

Dësh. Gordi. Oshg.

Thomaidha.

**(Hahen të gjitha.)**

5 E Premte † Dësh.

Theopemti e Theonai.

Osh. Fostiri. **(Kreshmë)**

**6 E Shtunë † Pagëzimi i Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht (Theofania).**

**7 E Diel † MBLEDHJA E JOAN PAGËZORIT, PARARENDËSIT.**

11 E Enjte † Osh.

Theodhos Qinovjarku.

Osh. Vitali.

13 E Shtunë † Dësh. Ermili,

Stratoniku. Osh. Maksim

Kafsokaliviti.

**14 E Diel † PAS**

**THEOFANISË.** Oshd. në Sina e Raitho. Shën. Nina.

17 E Mërkurë † \* Osh.

Andoni i Madh. Dësh. i ri

Gjergji në Janinë.

18 E Enjte † Athanasi

e Qirili të Aleksandrisë.

Dëshg. Theodhuli.

20 E Shtunë † Osh. Efthimi

i Madh. Dësh. i ri Zaharia.

**21 E Diel † 15 LLUKAIT.**

Maksim Omologjeti.

Dësh. Neofiti e Agnia.

22 E Hënë † Ap. Timotheu

nga të 70<sup>te</sup>. Oshd. Anastas

persiani.

25 E Enjte † Grigor

Theologu i

Konstandinopojës.

Osh. Marisi.

27 E Shtunë † Transf.

i lips. të Joan Gojartit.

Osh. Klimi në Sagmata.

**28 E DIEL † E**

**TAGRAMLEDH. E FARISEUT.**

Osh. Efrem siriani. **(Triodhi)**

30 E Martë † 3 Hierarkët:

Vasili i Madh, Grigor

Theologu, Joan Gojarti.

31 E Mërkurë Anargj. Kiri

e Joani. Nikita i Novgorodit.

**(Hahen të gjitha.)**

**Adresat e faqeve në Internet dhe ajo**

**e E-mailit, të Kishës Orthodhokse Autoqefale**

**të Shqipërisë, janë:**

Internet: [www.orthodoxalbania.org](http://www.orthodoxalbania.org)

E-mail: [orthchal@orthodoxalbania.org](mailto:orthchal@orthodoxalbania.org)

(Ju kërkohet ndjesë atyre që vizitojnë adresën e internetit për mosfunksionimin e saj për disa kohë, për arsye teknike.)

Nga 13-16 dhjetor Kryepiskopi i Athinës dhe i gjithë Greqisë Kristodhulos bëri një Vzitë në Vatikan. Është vizita e parë historike e një primati të Kishës Orthodhokse Greke dhe vjen pas vizitave të Papës Gjon Pali II në Greqi dhe asaj të fundit të Papës Benedikti XVI në Konstandinopojë.

Në takimin midis të dy hierarkëve u diskutua nevoja e veprimeve të përbashkëta për të përballuar sfidat e kohës dhe u theksua shpresa e kapërcimit të pengesave teologjike, me objektiv final rivendosjen e eukaristisë së përbashkët. Gjithashtu u shpreh qëndrimi i ngjashëm për çështje si aborti, të drejtat e njeriut, dialogu ndërfaqësor dhe roli i feve për paqen etj.



## Tiranë

### Gëzuar Krishtlindjet nga burgu 325!

Krishtlindja është festa e të gjithëve, edhe e të varfërve, edhe e të pasurve, festë e të gëzuarve dhe e të hidhëruarve...e të lirëve dhe e të burgosurve. Është bekim i veçantë të jesh në këtë kohë pranë të gjithë njerëzve, sidomos atyre që kanë nevojë për ngrohtësi, për besim dhe optimizëm. Këta njerëz ndodhen kudo, në çdo kënd të planetit, sikurse edhe në vendin tonë.

Në burgun 325 në Tiranë ndodhen 220 të burgosur prej të cilëve 140 janë burra dhe 80 gra. Prej 10 vjetësh, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ka qenë pranë këtyre personave me ndihma shpirtërore dhe materiale.

Me bekimin e Kryepiskopit Anastas, të parët që e morën iniciativën ishin të ndjerët atë Sotir Xhaferri dhe bashkëshortja e tij Marjana, të cilët hodhën hapat e parë të këtij bashkëpunimi që vazhdon

edhe sot, i ndjekur me kujdes dhe përkushtim nga disa misionarë që kanë ndihmuar në veprimtaritë humanitare të Kishës sonë në Shqipëri.

Këtë Krishtlindje ishte përgatitur një program i veçantë me dhurata të ndryshme, biseda shpirtërore, ikona të festës dhe një koncert i veçantë. Klerikë, përfaqësues nga grupi i grave dhe i rinisë orthodhokse zhvilluan një takim mbreslënës në ambientet e këtij burgu.

Përgjegjësjë e zyrës së grave, znj. Rajmonda Shqevi iu kujtoi të pranishmëve gjithë punën që është bërë në këto vite, duke theksuar se dhurata më e madhe që na ka dhënë Perëndia është mendja dhe gjërat e këqija le të harrohen, ndërsa të mirat të kujtohen, sepse falja që i bëjmë njëri-tjetrit është më e madhe.

Dhjakon Hektori kujtoi se në këtë festë ne i bëjmë shumë dhura-

ta njëri-tjetrit, por nuk duhet të harrojmë se dhurata më e madhe në këtë kohë është dhurata që na ka dhënë Perëndia të gjithëve ne. Ai na ka dhënë Birin e Tij të vetëm, Jisu Krishtin. Shumicën e rasteve ne mendojmë kur do të shkojmë në jetën tjetër. Por shpëtimi fillon në këtë kohë, në këtë jetë.

Krishti na thotë në Bibël që Mbretëria e Perëndisë është pranë jush. Bota rreth nesh është e rrethuar me ligësi dhe një nga emrat e Krishtit është Emanuel, që do të thotë: "Perëndia është me ne". Edhe në vështirësitë më të mëdha të jetës Perëndia është me ne. Ne përpiqemi të përrjetojmë Krishtin, sepse kur Perëndia është me ne, të gjithë jemi të mbushur me paqe, gëzim dhe dashuri.

Ndërsa kryedhjakon Asti tha ndër të tjera se njerëzit që kanë vizionin se Perëndia është me ne,

vjen një moment bëjnë një rezymë. Viti mbyllet dhe fillon viti i ri duke menduar se si duhet të jemi gjithmonë me Perëndinë.

Kjo mund të bëhet vetëm me optimizëm. Burrat dhe gratë e këtij burgu i pritën me ngrohtësi përfaqësuesit e Kishës sonë, duke biseduar dhe duke ndarë eksperiencat të shumta, duke bërë fotografi me njëri-tjetrin. Midis të tjerave, në një nga ambientet ku jetojnë dhe punojnë gratë e këtij burgu është ndërtuar edhe një serrë, dhuratë e Kishës Orthodhokse. Binte në sy dashamirësia dhe respekti i të gjithëve, duke uruar për zemërsisht për Krishtlindje të gëzuara dhe vit të bekuar.

*Isidor Kotti*



**NGJALLJA**

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

**Themelues:  
Kryepiskopi Anastas**

**Del nën kujdesin  
e Këshillit Botues**

**Kryeredaktor: Thoma Dhima**

**Adresa:  
Kryepiskopata Orthodhokse,  
Rruga e Kavajës, Nr. 151  
Tiranë**

**Tel: (042) 34-117, 35-095.**

**Fax: 32-109**

**Shtypur në shtypshkronjën "Ngjallja"**

## PAPA BENEDIKTI XVI TAKOHET ME PATRIARKUN EKUMENIK

Papa Benedikti XVI zhvilloi nga 28 nëntor -1 dhjetor një vizitë në Turqi. Ajo u konsiderua si një vizitë historike, e kryer në një kontekst të vështirë historik e social, ku vend kryesor zë çështja e tolerancës fetare dhe liria e ushtrimit të besimit fetar. Dhe mbase çasti më kulmor ishte vizita zyrtare në Patriarkanën Ekumenike.

“Shenjtëria Juaj dhe vëlla shumë i dashur më Krishtin, ne të urojmë mirëseardhjen me gëzim shumë të madh, nder dhe dashuri. I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit” theksoi Patriarku Ekumenik Vartholomeu I, teksa përshëndeti Papën dhe i uroi atij mirëseardhjen në aeroportin e Stambollit. Mbërritja e Papës në Fanar, u shoqërua me rënien festive të kabanave dhe u pasua nga një Dhoksologji në



Katedralen Patriarkale të Shën Gjergjit. Në fund të kësaj shërbese Patriarku i drejtoi Papës një mesazh mirëseardhjeje, i cili nga ana e tij iu përgjigj me shumë përze-

mërsi. Patriarku Ekumenik në fjalën e tij të mirëseardhjes, theksoi rëndësinë e këtij qyteti për historinë e Kishës së Krishterë. “Ky është qyteti ku u zhvilluan Sinodet Eku-

menikë të Kishës së hershme, vendi ku shumë shenjtore, martirë, konfesorë, theologë dhe mësues të Kishës u ndriçuan, vendi nga ku besimi i Orthodhoksëve i dha fuqi botës”- tha Patriarku.

Më 30 nëntor Papa Benedikti XVI mori pjesë në festën e Apostullit shën Andrea, Shenjtit Mbrojtës të Patriarkanës së Konstandinopojës. Papa u prit nga vetë Patriarku Ekumenik, që e shoqëroi deri në fronin e vendosur në Katedralen e Shën Gjergjit.

Pas celebrimit të Liturgjisë, të dy primatët diskutuan për çështje të ndryshme, me respekt dhe përkushtim ndaj angazhimeve të tyre si drejtuesit e dy Kishave respektive e në fund të këtyre bisedimeve nënshkruan një Deklaratë të përbashkët të rëndësishme.

### Nga Deklarata e përbashkët e Patriarkut Ekumenik Vartholomeu I dhe Papës Bendikti XVI

1. Takimi vëllazëror i dy primatëve të Kishave rinovon angazhimin e tyre drejt rivendosjes së bashkimit midis të dy Kishave, që është vullnet dhe urdhër i Perëndisë.

2. Të dy Prelatët evokuan me mirënjohje paraardhësit e tyre, Papët Pavli VI dhe Gjon Pavli II, si edhe Patriarkët Ekumenikë Athenagoras dhe Dhimitrios, të cilët hapën rrugën drejt pajtimit midis dy Kishave, nëpërmjet takimeve dhe vizitave të tyre të ndërsjella, ashtu si edhe heqja e anatemave të shek. të XI-të midis Romës dhe Konstandinopojës. Ata u bënë thirrje besimtarëve të dy Kishave të forcojnë lutjet dhe përpjekjet e tyre drejt unitetit të Kishave.

3. Ata shprehën gëzimin dhe kënaqësinë për rinisjen zyrtare të Dialogut Theologjik midis të dy Kishave, ashtu si edhe për takimin e pak ditëve më parë të sesionit plenar të Komisionit të Përbashkët për Dialogun Theologjik, në Beograd, duke ofruar mbështetjen e tyre të plotë për të.

4. Ata nënvizuan detyrën e Kishës për të çuar mesazhin e Ungjillit në botën e sotme, sidomos në vendet e krishtera, ku, veçanërisht në Perëndim, vërehen shekullarizim, relativizëm e madje nihilizëm. Trashëgimia e përbashkët e të dy Kishave duhet të marrë parasysh rrjedhat moderne kulturore, kërkesat si edhe problemet e njerëzimit në botën e sotme.

5. Duke iu referuar formimit të Bashkimit Evropian, ata theksuan se: “Ne vlerësojmë pozitivisht ecjen drejt krijimit të Bashkimit Evropian. Aktorët e kësaj nisme të madhe me siguri do të marrin në konsideratë të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me personin njerëzor e të drejtat e tij të padiskutueshme, sidomos lirinë e besimit, dëshmitare dhe garantuese të respektimit të çdo të drejte tjetër. Në çdo nismë për unifikimin, minorancat duhet që të mbrohen me traditat e tyre kulturore dhe specifikat fetare. Në Evropë, së bashku, të krishterët orthodhoksë dhe ata romanokatolikë, duke mbetur të hapur ndaj besimeve të tjera dhe kontributit të tyre në kulturë, duhet të bashkohen forcat për të ruajtur rrënjët, traditat dhe vlerat e krishtera, për të siguruar respektin për historinë, si edhe për të kontribuar në kulturën e Evropës së ardhshme, si edhe për cilësinë e marrëdhënieve njerëzore në të gjitha nivelet. Në këtë kontekst, si

mund të mos evokosh kujtimin e martirëve të hershëm dhe të trashëgimisë së lavdishme të Krishterë të vendit në të cilin jemi takuar, duke u nisur nga ç’thotë Libri i Veprave të Apostujve, duke evokuar figurën e Shën Pavlit, Apostullit të Kombeve? Në këtë tokë, u takuan mesazhi i Ungjillit dhe tradita antike filozofike. Kjo lidhje, që kaq shumë ka kontribuar në trashëgiminë tonë të përbashkët të Krishterë, mbetet aktuale dhe në të ardhmen do të sjellë sërish fryte, për unifikimin dhe unitetin tonë”

6. Ata kthyen sytë nga vendet ku të Krishterët ndeshen me vështirësi dhe ku mbizotërojnë luftëra, terrorizmi dhe uria, ashtu si edhe shfrytëzimi shumëformësh i të varfërve, emigrantëve, grave dhe fëmijëve.

Ata u bëjnë thirrje Orthodhoksëve dhe Romanokatolikëve të ndërmarrin aksione të përbashkëta për respektimin e të drejtave njerëzore të të gjithëve dhe për mbrojtjen e jetës njerëzore nga masakra të të pafajshmëve, sidomos kur bëhet në emër të Perëndisë.

Veçanërisht, ata kthyen sytë nga Lindja e Mesme, ku Zoti jetoi e ku të krishterët kanë jetuar prej shekujsh. Ata theksuan nevojën për rivendosjen e paqes në atë zonë dhe për një bashkëjetesë paqësore dhe bashkëpunim midis popujve, kishave dhe besimeve, si dhe nxitën dialogun ndërjetar, në mënyrë që të kundërshtohet çdo formë dhune dhe diskriminimi.

7. Ata shprehën shqetësimin përballë rrezikut të madh që vjen nga shkatërrimi i mjedisit natyror dhe pasojat negative për njerëzimin dhe për gjithë krijesën, të shkaktuara nga progresi i pakontrolluar ekonomik dhe teknologjik. Si udhëheqës shpirtërorë, ata mbështetën çdo përpjekje për mbrojtjen e mjedisit, në mënyrë që t’u lihet brezave të ardhshëm një planet ku mund të jetohet.

8. Së fundi, ata iu drejtuan të gjithë besimtarëve Romanokatolikë dhe Orthodhoksë kudo në botë, klerikëve, murgjive dhe laikëve, duke iu dhënë bekimin dhe sigurinë se ata do të kenë lutjet dhe dashurinë e tyre, ashtu si edhe të gjithë të krishterët e tjerë, ndaj të cilëve janë të predispozuar dhe të gatshëm për të hyrë në dialog dhe bashkëpunim.